

# RRITJA E TRANSPARENCËS DHE PROMOVIMI I VENDIMARRJES ME PJESËMARRJE NË QEVERISJEN VENDORE NE SHQIPËRI



## FALENDERIME

Projekti “RRITJA E TRANSPARENCËS DHE PROMOVIMI I VENDIMARRJES ME PJESËMARRJE NË QEVERISJEN VENDORE NE SHQIPËRI” është realizuar me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS.

Falenderojmë për bashkëpunimin dhe kontributin në aktivitetet e organizuara në kuadër të këtij projekt Bashkitë dhe Këshillat Bashkiak të qyteteve: Durrës, Elbasan, Kukës, Lezhë dhe Pogradec.



Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Transparency International Albania dhe nuk reflekton domosdoshmërisht opinionet e donatorit.

# **RRITJA E TRANSPARENCËS DHE PROMOVIMI I VENDIMARRJES ME PJESËMARRJE NË QEVERISJEN VENDORE NE SHQIPËRI**

**Përgatiti :**

**Danjela Çollaku**

**Analiza ligjore :**

**Edlira Jorgaçi, eksperte ligjore**

**Monitorues:**

**Ledia Kadiasi**

**Esi Qafoku**

**Mars 2014**



## **P**ERMBAJTJA:

- HYRJE

- ANALIZE LIGJORE E LEGJISLACIONIT QE RREGULLON FUNKSIONIMIN E ORGANEVE TE QEVERISJES VENDORE NE SHQIPERI

- BASHKIA DURRES

- BASHKIA ELBASAN

- BASHKIA KUKES

- BASHKIA LEZHE

- BASHKIA POGRADEC

- REKOMANDIME

# HYRJE

Vitet e fundit ka një tendencë të nxitjes së transparencës në nivelin lokal, për të garantuar kështu mirëqeverisjen e njësisive të qeverisjes vendore.

Për pjesën më të madhe të qytetarëve, qeverisja vendore është përballja kryesore që kanë me sektorin publik, duke filluar nga prokurimet publike, procedurat për lejet e ndërtimit apo liçencat e ndryshme, e deri në shërbimet thelbësore si shkollat apo strehimi.

Në Raportin e Progresit të 2012, të hartuar nga Komisioni European për Shqipërinë, nënvizohet fakti se qeverisja vendore karakterizohet nga mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe nga mungesa e konsultimit me organizatat e shoqërisë civile apo grupeve të tjera të interesit.

Duke patur parasysh këto problematika, projekti i propozuar nga TIA ka patur si qëllim rritjen e transparencës dhe nxitjen e mirëqeverisjes së njësisive të qeverisjes vendore, duke u fokusuar në veprimtarinë e Këshillit Bashkiak, si një nga organet më të rëndësishëm vendimmarrës në qeverisjen lokale.

Ky publikim vjen si rezultat i monitorimit disa mujor (shtator 2013 - shkurt 2014) të transparencës së veprimtarisë së Këshillit Bashkiak e Bashkive: Durrës, Elbasan, Kukës, Lezhë dhe Pogradec.

Kjo analizë është përgatitur në kuadër të projektit “Rritja e transparencës dhe promovimi i vendimmarrjes me pjesëmarrje në qeverisjen vendore në Shqipëri”, i realizuar me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS, dhe përfshin gjetjet e monitorimit duke patur një theks të veçantë tek transparenca në zhvillimin e aktiviteteve të këshillit bashkiak.

Në periudhën Gusht - Shtator 2013 TIA ka zhvilluar takime dhe ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me secilën prej bashkive të përfshira në projekt, në mënyrë që të sigurohej një angazhim maksimal në realizimin e aktiviteteve të parashikuara.

Në periudhën shtator 2013 - shkurt 2014, grupi i punës i projektit, bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e njësisive të qeverisjes vendore ka kryer rolin e monitoruesit të mbledhjeve të këshillave bashkiakë, duke evidentuar problemet e ndryshme apo veprimet që nuk kanë qënë në përputhje me ligjin.

Krahas monitorimit të rregullt dhe të vazhdueshëm të mbledhjeve, gjetjet e këtij punimi janë bazuar dhe në seminarët e zhvilluara në secilin prej qyteteve: Durrës, Elbasan, Kukës, Lezhë dhe Pogradec.

Në këto takime, përfaqësues të bashkisë, këshillit bashkiak dhe organizatave të shoqërisë civile, kanë diskutuar dhe kanë ndarë eksperiencat e tyre në drejtim të nxitjes së transparencës në qeverisjen vendore.

Një ndër aktivitetet e këtij projekti, ka qënë dhe ndërtimi i një ueb-faqeje, e cila përmban një sërë informacionesh mbi aktivitetet e projektit dhe mbi

mbledhjet dhe vendimet e marra nga këshillat bashkiakë të monitoruar.

Në përfundim, ky punim ofron po ashtu dhe rekomandime për njësitë e qeverisjes vendore, për ato problematika që meritojnë një vëmendje të veçantë dhe një angazhim më të madh nga ana e tyre, në kuadër të rritjes së transparencës dhe garantimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

## FOTOT NGA SEMINARET E ZHVILLUARA NË KUADËR TË PROJEKTIT



**KUKES**



**DURRES**



**POGRADEC**



**ELBASAN**



**LEZHE**

# ANALIZE LIGJORE E LEGJISLACIONIT QE RREGULLON FUNKSIONIMIN E ORGANEVE TE QEVERISJES VENDORE NE SHQIPERI

## Kush janë njësitë e qeverisjes vendore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore<sup>1</sup>.

Pjesa e gjashtë e Kushtetutës, ka hedhur bazën e hartimit të legjislacionit mbi qeverisjen vendore duke përcaktuar organet vendore, mënyrën e zgjedhjes së tyre, disa nga detyrat e kompetencat kryesore të tyre, dhe në mënyrë të veçantë përcaktimin dhe mbrojtjen e të drejtës për vetëqeverisje.

Në përputhje me këto përcaktime kushtetuese Ligji Nr.8652 datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore<sup>2</sup>”, i ndryshuar, parashikon se njësitë bazë të qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë. Organet e komunave ose bashkive zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë dhe ndahen në organe përfaqësuese të njëjësive bazë të qeverisjes vendore që janë këshillat, dhe organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës, i cili është

kryetari i bashkisë ose i komunës. Qarku është gjithashtu njësi e qeverisjes vendore dhe përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkëta. Në qark ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe harmonizohen me politikën shtetërore. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut.

## Aktet normative të njëjësive të qeverisjes vendore

Organet e njëjësive të qeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.

Në ushtrim të kompetencave të tyre organet e qeverisjes vendore kanë të drejtë të nxjerrin akte. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe, ndërsa parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Neni 13 i Kushtetutës

<sup>2</sup> Në vazhdim “ligji për qeverisjen vendore”

---

<sup>3</sup> Neni 116 dhe neni 120 i Kushtetutës



Ligji nr.8652 datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, normon veprimtarinë institucionale të organeve të qeverisjes vendore.

Sipas nenit 113 të Kushtetutës dhe nenit 8 pika b të ligjit të sipërcituar, organet e qeverisjes vendore për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, nxjerrin:

- Urdhëresa ;
- Vendime dhe
- Urdhra,

që janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e përfshira në akt, në juridiksionin e këtyre organeve.

Këshillat bashkiakë/komunalë nxjerrin:

- vendime me karakter normativ dhe
- vendime me karakter individual, të detyrueshme për t’u zbatuar nga subjektet nën juridiksionin e tyre.

Ligji nr.8652 datë 31/07/2000, i ndryshuar, normon me hollësi procesin e shqyrtimit, votimit dhe shpalljes së akteve të këshillave bashkiakë/komunalë. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë. Këshilli vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, përveçse kur miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve, vendim i cili kërkon votat e tre të pestave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

### Detyrat dhe kompetencat e njësive të qeverisjes vendore

Detyrat dhe kompetencat e organeve të qeverisjes vendore, këshillit komunal ose bashkiak, kryetarit të komunës ose bashkisë dhe këshillit të qarkur, janë të përcaktuara respektivisht në nenet, 32, 44 dhe 54 të ligjit nr.8652 datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Në analizë të këtyre neneve rezulton se këshillat bashkiakë/komunale kanë funksionet kryesore dhe më të rëndësishme vendimmarrëse, si caktimi i taksave dhe tarifave vendore, miratimin e buxhetit vjetor, marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, miratojnë tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve, apo dhe vendimarrje mbi territorin dhe pronat që i kanë kaluar tashmë në administrimin vendor.

Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut, janë të ngjashme me ato të këshillit komunal/bashkiak. Është për t’u theksuar fakti se ndërsa detyrat dhe kompetencat e këtyre organeve janë parashikuar në nenet përkatëse në një listë të mbyllur, kryetari i bashkisë ose komunës fiton edhe kompetenca dhe detyra “mbetëse”, pasi në pikën a të nenit 44 është parashikuar: “ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës”.

## Transparenca / Qasja e publikut

### Informimi dhe pjesëmarrja në vendimmarrje

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë, synon të sigurojë qeverisje në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të komuniteteve, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera, nxitjes efektive të pjesëmarrjes së komunitetit në qeverisjen vendore, etj.

Marrëdhëniet e organeve të qeverisjes vendore me publikun, përfshijnë në vetvete shumë role dhe funksione, e që realizohen në përputhje me Kushtetutën, Kodin e Proçedurave Administrative, ligjin nr. 8503 datë 30/06/1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Ligjin nr.9131, date 08/09/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Ndër këto funksione mund të përmendim:

- a) informimin për komunitetin qytetar;
- b) marrjen dhe ndjekjen e kërkesë-ankesave;
- c) asistencën e drejtpërdrejtë për zgjidhjen e problemeve dhe sigurimin e shërbimeve për qytetarët.

E drejta e informimit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23<sup>4</sup> të saj, Kodi i Proçedurave Administrative dhe ligji nr. 8503 datë

30/06/1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Ligji nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, në nenin 34 të tij, përcakton se:

“Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit”.

Ndërsa ky nen garanton të drejtën e publikut për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit, neni 35 i ligjit, parashikon detyrimin e këshillit komunal ose bashkiak, që përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve të zhvillojë seanca këshillimi me komunitetin, duke përcaktuar në mënyrë taksative edhe rastet në të cilat ky këshillim është i detyrueshëm. Ligji ka parashikuar edhe modalitetet e njoftimit për mbledhjen e këshillit, i cili duhet të përmbajë datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes dhe të bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media.

Mënyra se si zhvillohet proçesi i pjesëmarrjes së publikut në mbledhjet e këshillit komunal ose bashkiak, përcaktohet në rregulloren e këshillit duke përdorur një nga format e ndryshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

---

<sup>4</sup> 1.E drejta e informimit është e garantuar.

2.Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

3.Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

## Njohja me aktet

Akti është materializimi ose produkti i procesit vendimmarrës. Edhe pse publikut mund t' i jetë garantuar pjesëmarrja në procesin vendimmarrës, në rast se atij nuk do t'i garantoheshin mundësi efektive për njohjen me aktin ku u finalizua ky proces, pjesëmarrja do të humbiste vlerën e saj.

Publikimi i akteve zyrtare është kusht që subjektet fizike dhe juridike të mund të njohin normat ligjore që nxjerrin organet qeverisëse në mënyrë që t'i zbatojnë ato.

Përsa i përket shpalljes dhe hyrjes në fuqi të vendimeve të këshillave bashkiakë/komunalë, neni 33 paragrafi 6 i ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000, i ndryshuar përcakton se:

“Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të këtyre subjekteve që përfshihen në to.”

Aktet e Këshillit afishohen në vende publike të caktuara nga ky i fundit, brenda territorit të komunës apo bashkisë dhe sipas mundësive këshilli cakton dhe forma të tjera të publikimit të tyre.

Neni 35 paragrafi 3 i ligjit 8652 datë 31/07/2000, i ndryshuar përcakton se:

“Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”

dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.

Në këtë dispozitë e drejta e informimit garantohet në dy plane: “informim pasiv” i publikut nga vetë organi që nxjerr aktin dhe “informimi aktiv” i cili iniciohet nga i interesuari me anë të një kërkesë që bazohet në të drejtën e tij për informim. Në rastin e dytë, janë vetë qytetarët që kanë të drejtë të kërkojnë informacion përmes një kërkesë e cila depozitohet pranë organit i cili ka informacionin e kërkuar.

Sa i përket transparencës në veprimtarinë e këshillit të qarkut, ligjvënësi, ka ruajtur të njëjtin standart si për këshillin komunal ose bashkiak, kur parashikon se ai zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese dhe ekzekutive të komunave dhe bashkive dhe me komunitetet përkatëse, si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar, dhe përsa i përket mënyrës sesi procedohet, referon në nenet (e analizuar më sipër), 34 dhe 35 të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000, të ndryshuar.

Si përfundim mund të themi se zbatimi rigoroz i dispozitave të sipërcituara është kusht për të garantuar aksesin e publikut në legjislacionin lokal në kuptimin e njohjes efektive të tij me aktet që miraton këshilli bashkiak.

## Konkluzione

Nga sa më sipër është e qartë që ligji nr.8652 datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, ka të transpozuar me kujdes disa parime të rëndësishme kushtetuese me synimin e qartë për të garantuar një proces

vendimarrës transparent dhe të hapur ndaj publikut.

Ligjvënësi ka lidhur organikisht në dispozitat e Ligjit 8652 rregullat dhe procedurën për vendimarrjen e të zgjedhurve vendorë me të drejtën e publikut për të qenë i përfshirë në këtë vendimarrje. Kjo përfshirje e publikut aktivizohet në fillim, gjatë dhe në fund të procesit vendimarrës. Konkretisht kjo nënkupton shqyrtimin paraprak të një kategorie aktesh me publikun e interesuar, ndjekjen e mbledhjeve në sallë teksa ato zhvillohen si dhe aksesin në vendimet e materializuara të Këshillit. Kjo e fundit garantohej nëpërmjet informimit nga vetë Këshilli bashkiak/komunal dhe informimit nëpërmjet referimit direkt në dispozitat e ligjit 8503.

Ajo që vërehet në analizë të fundit është se, nenet 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendorë", i ndryshuar, synojnë garantimin e një procesi vendimarrës transparent dhe të hapur ndaj publikut, kurse neni 33 normon në tërësi procedurën e votimit dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të Këshillit.

Nëse këto tre nene zbatohen në mënyrë të përpiktë, atëherë procesi vendimarrës është i ligjshëm dhe transparent.

Matja e nivelit të zbatimit të neneve 34 dhe 35 është indikatori për vlerësimin objektiv të nivelit të përfshirjes së publikut në vendimarrjen lokale dhe transparencës së kësaj të fundit, kurse matja e nivelit të zbatimit të nenit 33 është indikatori për ligjshmërinë e akteve.

## **Indikatorët e monitorimit :**

### **Implementimi i nenit 33**

#### **Indikator – Vendime të marra me votim të fshehtë (neni 33/1)**

Këshilli merr vendime me karakter normativ dhe me karakter individual. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë. Aktet me karakter normativ, si parim miratohen me votim të hapur, por këshilli mund të vendos të procedojë me votim të fshehtë rast pas rasti.

**Indikator – vendime të marra me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm (neni 33/3), vendime të marra me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit (33/4), vendime të marra me shumicën e tre të pestave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit (neni 33/5)**

Si parim vendimet e këshillit merren me shumicë të thjeshtë. Ligji ka parashikuar shprehimisht se merren me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

vendimet që kanë të bëjnë me:

- ❖ Zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të këshillit;

- ❖ Emërimin dhe shkarkimin e sekretarit të këshillit komunal ose bashkiak;
- ❖ Miratimin e akteve të themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose është bashkëthemelues;
- ❖ Miratimin e buxhetit dhe ndryshimet e tij;
- ❖ Taksat e tarifave vendore, si dhe nivelin e tyre;
- ❖ Marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- ❖ Krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- ❖ Zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut;
- ❖ Dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit,
- ❖ Kur vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur,

Për miratimin e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të tretëve, është parashikuar në ligj shumica e cilësuar prej tre të pestave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

### **Indikator – shpallja dhe hyrja në fuqi e vendimeve (neni 33/6 dhe 35/3)**

Shpallja është momenti nga i cili nis njoftimi i vendimeve të marra, subjekteve të interesuara. Akti duhet të parashikohet në tekstin e tij, ditën e shpalljes e cila duhet të jetë brenda 10 ditëve nga data e miratimit/votimit të tyre.

Administrata e bashkisë ose komunës duhet të kryej të gjitha ato veprime që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative, për shpalljen e aktit.

Lidhur me hyrjen në fuqi, vlerësimi duhet të kryhet jo vetëm me përcaktimin e kohës së hyrjes në fuqi që lidhet me ditën e shpalljes, por edhe me vendin ku është bërë shpallja.

Neni 35/35 ka sjell detyrimin për këshillin bashkiak/komunal që të ketë përcaktuar, minimalisht vende publike brenda territorit të tij, dhe sipas mundësive, të përcaktojë edhe forma të tjera publikimi si shpallja në një gazetë, në një uebsite zyrtar, etj.

### **Implementimi i nenit 34<sup>6</sup>**

#### **Indikator – Mbledhjet e hapura (34/1)**

Neni 34/1 i jep çdo qytetari të drejtën të ndjek mbledhjet e këshillit. Mënyra se si mund të ndiqen këto mbledhje duhet të përcaktohet në rregulloren e këshillit. Në këtë këndvështrim, këshilli së pari duhet të ketë një rregullore të miratuar e të mirërrregulluar për modalitetet e ndjekjes së mbledhjeve nga publiku. Së dyti e drejta e publikut për ndjekjen e mbledhjeve duhet të garantohet dhe jo thjesht të afirmohet. Kushtetuta në nenin 23/3 ka parashikuar se: “Kujtëdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e

<sup>5</sup> Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.

<sup>6</sup> **Mbledhjet e hapura**

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

organeve të zgjedhura kolektive". Mundësia është psh. vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme, ose zhvillimi i mbledhjeve në vende ku ato mund të ndiqen nga të gjithë të interesuarit, etj.

### **Indikator – Njoftimi mbledhjeve (neni 34/2)**

Njoftimi si akt duhet të përmbajë disa elementë thelbësor si datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes, mungesa e të cilëve çon në mosrealizimin efektiv të tij, si dhe të publikohet në vende të caktuara nga këshilli, që mund të jenë vendosja në stenda, njoftimi me telefon, email, publikimi në ëebsite dhe në media, që mund të jetë e shkruar ose audiovizuale.

### **Indikator – Mbledhjet e mbyllura (neni 34/3)**

Matja e këtij indikator është tregues i drejtëpërdrejt i ndalimit të aksesit të publikut.

## **Implementimi i nenit 35<sup>7</sup>**

### **Indikator – Këshillimi me komunitetin gjatë shqyrtimit dhe miratimit të akteve (neni 35/1 e 35/2)**

Ligji ka parashikuar rastet në të cilat këshillimi me komunitetin është i detyrueshëm:

- ❖ Kur miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;
- ❖ Kur miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ❖ Kur vendos për taksat e tarifave vendore, si dhe nivelin e tyre;
- ❖ Kur miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Edhe për vlerësimin e këtij indikator është e rëndësishme që këshilli të ketë hartuar e miratuar një rregullore efikase ku të ketë përcaktuar mënyrat e konsultimit, ndërkohë që vet ligji ka orientuar në përdorimin e formave të

---

<sup>7</sup> 1.Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji.

2.Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

2/1.Për këshillat komunalë/bashkiakë janë të detyrueshme seancat e këshillimit me kryetarët dhe kryesinë e fshatrave nën juridiksion, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjat "ç", "dh", "e", "f", "k" dhe "ll" të nenit 32 të ligjit. Seancat e këshillimit, në këtë rast, shënohen në procesverbal.

3.Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

tilla si, takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

**Indikator – Afishimi i akteve të miratuara (informimi pasiv)**

Çështja e afishimit është trajtuar tek indikator i “ shpallja dhe hyrja në fuqi e vendimeve”.

# BASHKIA DURRES

## Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Durrës (KBD)

Transparenca e qeverisjes vendore në qytetin e Durrësit, si te legjislativi ashtu edhe tek ekzekutivi, ka shënuar ngritje vitet e fundit, duke bërë që qytetarët, e sidomos shoqëria civile, të kenë më shumë informacione rreth aktiviteteve të saj.

Këshilli Bashkiak Durrës, si pasojë e ndryshimit të koalicioneve partiake të krijuara për zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2013, ka patur një periudhë ngërçi tre mujore, gjatë së cilës është kërkuar interpretimi i Prefektit nga ana ligjore për rrethanat e krijuara.



Në vijim, në mbledhjen e muajit shtator Këshilli Bashkiak i Durrësit ka zgjedhur kryetarin dhe nënkryetarin e tij të ri, pas dorëheqjes së atyre të mëparshëm. Proçedura e votimit për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit të ri u bë me votim të fshehtë, duke respektuar të gjitha proçedurat që parashikon ligji për qeverisjen vendore në këtë rast, duke qënë se këto vendime konsiderohen si akte me karakter individual. Vlen të theksohet se në këtë mbledhje ka munguar prezenca e përfaqësuesve të opozitës.

Lidhur me hyrjen në fuqi të këtyre akteve, ligji parashikon se ato hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të subjekteve të përfshira në të<sup>8</sup>, ndërsa në vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës është parashikuar se ato hyjnë në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Prefekti (pavarësisht se shpallja e tyre është parashikuar në datën kur është marrë vendimi). Gjithashtu, në rastin e dhënies së mandatit për këshilltarët e rinj (në rastin e zëvendësimit/largimit të atyre ekzistues), apo të zgjedhjes së përfaqësuesve në Këshillin e Qarkut, votimi nuk është bërë i fshehtë ashtu siç e përcakton ligji.

Për sa i përket proçesit të njoftimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, ai është realizuar duke respektuar afatin ligjor 5 ditor (afat në minimum), duke i dhënë mundësinë qytetarëve që të informohen për mbledhjet, si edhe komisioneve përkatëse të këshillit bashkiak që të mblidhen paraprakisht për të diskutuar aktet e ndryshme që priten të miratohen në mbledhjen e radhës. Njoftimi, krahas ditës, vendit dhe orës së zhvillimit të mbledhjeve, ka patur në përmbajtje dhe rendin e ditës, i cili ka paraqitur me pika të gjitha çështjet që do të shtrohen për diskutim apo miratim në mbledhjen e radhës. Krahas publikimit në mjediset e bashkisë, ai është publikuar dhe duke përdorur forma të tjera, si: publikimi në mediat lokale apo në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës. Mediat lokale kanë

---

<sup>8</sup> Neni 33/6 Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.



dhënë informacion dhe mbi zhvillimin e mbledhjes dhe vendimet e marra në to.

Mbledhjet e KBD kanë qënë kurdoherë të hapura për publikun dhe në asnjë rast nuk është ndaluar pjesëmarrja e personave të interesuar në këto mbledhje. Në rregulloren e KBD është parashikuar detyrimi i sekretarit të këshillit për të mbajtur një listë të personave dhe organizatave<sup>9</sup> që kanë depozituar një kërkesë me shkrim për të marrë njoftim për zhvillimin e mbledhjeve dhe rendin e ditës.



Kryetari i Këshillit (si kryesues i mbledhjeve), në të gjitha rastet, nuk ka reflektuar ndonjë preferencë të veçantë për asnjërin grupim politik, ndaj edhe ka bërë që seancat të kalojnë pa ndonjë problem të theksuar, dhe kështu nuk ka ndodhur që të merren masa ligjore ndaj anëtarëve apo të ketë ndërprerje të diskutimeve, marrjes së fjalës, largimit nga seanca apo edhe masa tjera të parashikuara nga aktet ligjore.

Një moment tjetër i rëndësishëm është ai i afishimit të akteve të Këshillit Bashkiak. Neni 35/3 sjell detyrimin për Këshillin Bashkiak që të ketë përcaktuar, minimalisht vende publike brenda territorit të tij, dhe sipas mundësive, të përcaktojë edhe forma të

tjera publikimi si shpallja në një gazetë apo në një ueb-faqe zyrtare.

Nga monitorimi ka rezultuar se në Rregulloren e KBD përcaktohet detyrimi për shpalljen e tyre në hollin e bashkisë dhe jashtë godinës së saj, si edhe në median lokale. Bashkia Durrës i publikon në mjediset e saj dhe në median lokale. Një fakt pozitiv është që vendimet e KBD pasqyrohen në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës<sup>10</sup>.

### Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak të Durrësit

Duke patur parasysh kërkesat që përcakton ligji për qeverisjen vendore, kryetari i bashkisë dhe pjestarë të administratës kanë qënë prezent në të gjitha mbledhjet e këshillit duke dhënë sqarime për aktet që dotë miratoheshin, duke raportuar për gjendjen ekonomiko-financiare, apo edhe për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë, sa herë që kjo e fundit është kërkuar nga këshilli.

<sup>9</sup> Neni 59 i Vendimit Nr. 1, datë 30.01.2004 i KBD "Për miratimin e Rregullosës së Brendshme të funksionimit të Këshillit Bashkiak"

<sup>10</sup> Në sajë të një projekti, Bashkia Durrës në bashkëpunim me organizatën Infocip ka mundur publikimin e tyre në një uebsite të postaçëm <http://ëëë.vendime.al/category/durres/>.

## Faqja Zyrtare e Bashkise Durrës

Faqja zyrtare e Bashkisë Durrës është mjaft e pasur me informacion si për bashkinë ashtu edhe për këshillin bashkiak. Ajo ofron informacion të zgjeruar mbi shërbimet që ofrohen nga bashkia për qytetarët, projektet e ndryshme të zbatuara ose në zbatim, formularët e ndryshëm për aksesin në shërbime etj.



Një aspekt mjaft pozitiv është përmbajtja e një linku të veçantë, i cili bën të mundur njohjen me përmbajtjen e plotë të vendimeve të marra nga Këshilli Bashkiak dhe shkarkimin e tyre. Gjithashtu, një risi e Bashkisë Durrës është ofrimi i shërbimeve nëpërmjet opsionit “e-government”. Ky bën të mundur që nëpërmjet aksesit në internet apo në disa kompjutera të vendosur në zonat më të populluara në qytet, qytetarët mund të marrin informacion dhe shërbime të drejtëpërdrejta nga bashkia<sup>11</sup>.

## Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje

Transparenca e qeverisjes ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në nxitjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Ligji për qeverisjen vendore i parashikon në mënyrë jo shteruese disa nga mekanizamt për pjesëmarrjen e publikut në

vendimmarrje<sup>12</sup>. Nga monitorimi i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Durrës rezulton se prej vitesh zbatohet në masë praktika e buxhetimit me pjesëmarrje, si një ndër fazat paraprake për hartimin e buxhetit të bashkisë për vitin pasardhës. Krahas këtyre konsultimeve publike që zhvillohen në çdo njësi përbërëse të territorit të bashkisë (lagjet), Bashkia Durrës ka një projekt të quajtur “ndërlidhësit komunitar”, i cili bënë të mundur zgjedhjen e një përfaqësuesi nga komuniteti i çdo lagjeje, që takohet me administratën e bashkisë për t’i përcjellë problemet e tyre. Kjo i shërben bashkisë që më pas të organizojë takime diskutimi me banorët, duke patur në fokus pikërisht problematikat e përcjella prej tyre nga ky ndërlidhës. Prezantimi i projekt-buxhetit dhe paketa fiskale për 2014 në KBD u realizua nga Bashkia Durrës para përfundimit të vitit fiskal 2013, por si pasojë e analizimit të tij të mëtejshëm nga anëtarët e KBD dhe zhvillimit të një seance konsultimi nga vetë KBD me qytetarët, miratimi i tij u bë në muajt e parë të 2014.

Një nisëm tjetër mjaft e suksesshme e vënë re gjatë monitorimit të KBD, është ekzistenca e Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor (KKQV), i cili përbëhet nga drejtues dhe përfaqësues të OJQ-ve vendore, bizneseve, rinisë, grave dhe grupeve të marxhinalizuara<sup>13</sup>.

<sup>11</sup> Psh: nxjerrja e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore

<sup>12</sup> Neni 35, Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE”

<sup>13</sup> Për më shumë: <http://www.durres.gov.al/index.php/zyrashtypit/378-ngrihet-ne-durres-komisioni-keshillimor-qytetar-vendor-projekt-i-usaid-ne-bashkepunim-me-bashkine-e-durresit>

KKQV shërben si organ këshillimor për bashkinë dhe këshillin bashkiak dhe ka një përfaqësim të gjerë (madje edhe gjeografik) me qytetarë që kanë vizion dhe duan të mundësojnë ndryshime pozitive në qytetin e tyre.

Ky komision ka si synim të bëjë të mundur trajtimin e sa më shumë

tematikave dhe problemeve me rëndësi për komunitetin. KKQV do të institucionalizohet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe do të mbledhet rregullisht për çështje që lidhen me buxhetimin, paketën vjetore fiskale, ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve vendore, planifikimin e territorit, si dhe evidentimin e përparësive të qytetarëve.

## BASHKIA ELBASAN

### Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Elbasan (KBE)

Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak Elbasan prej vitesh kanë garantuar transparencën në ushtrimin e funksioneve të tyre, si edhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Në përputhje me përcaktimin e ligjit për qeverisjen vendore për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak çdo muaj, gjatë monitorimit është vënë re zbatimi rigoroz i këtij detyrimi, dhe shpesh dhe zhvillimi i mbledhjeve më të shpeshta për t'i shërbyer në maksimum nevojave të qytetarëve.



Mbledhjet e KBE kanë qënë të hapura për publikun, duke bërë të mundur që përfaqësues të organizatave jo-qeveritare, qytetarë dhe mediat lokale të jenë të pranishëm në të gjitha mbledhjet e monitoruara. Ka patur raste madje, kur qytetarët kanë parashtruar personalisht para anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesve të Bashkisë Elbasan probleme që prekin komunitetin ku ata jetojnë.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KBE në mbledhjet e monitoruara ka qënë tepër e rregullt dhe pjesa më e madhe e tyre kanë qënë mjaft aktiv në diskutimin mbi çështjet e rendit të ditës, apo edhe në prezantimin para Këshillit të problemeve të ndryshme të komunitetit, si përfaqësues të zërit të qytetarëve.

Kryetari i Bashkisë, vlerësohet për mënyrën e komunikimit me subjektet politike të përfaqësuara në Këshillin Bashkiak, shoqërinë civile dhe afërsinë me qytetarët, duke u dhënë hapësirë në shprehjen e mendimeve dhe këshillimet për procese të ndërlikuara dhe çështje të ndjeshme. Ndërkaq, edhe Kryetari i KBE, i ka drejtuar mbledhjet në përputhje me Rregulloren e KBE, duke lënë në dispozicion maksimal kohën e trajtimit të çështjeve të rendit të ditës, dhënien e mundësisë për diskutime dhe trajtimin e barabartë të të gjithë anëtarëve, pavarësisht përkatësisë politike.

Të gjitha fazat e zhvillimit të mbledhjeve si: njoftimi, zhvillimi i tyre dhe afishimi i vendimeve, janë kryer në përputhje të plotë me afatet dhe mënyrën e parashikuar në ligjin për qeverisjen vendore. Është e rëndësishme të theksohet se KBE ka miratuar në 2004 Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak, ku ka parashikuar në mnëyrë specifike dhe tejet të hollësishme të gjitha modalitetet me anë të të cilave realizohen seancat e këshillimit me bashkësinë, gjë e cila nuk është hasur në asnjërin prej Këshillave Bashkiakë të monitoruar<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Vendimi Nr. 34, datë 20.05.2004 i KBE "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak", pjesa XI, neni 94-98. Në Rregulloret e

Për sa lidhet me afishimin e vendimeve, krahas afishimit në mjediset e Bashkisë dhe njoftimit nëpërmjet mediave lokale, në faqen zyrtare të internetit publikohen informacione mbi vendimet e marra<sup>15</sup>.

Një nisëm tjetër mjaft e rëndësishme është finalizuar në Tetor të 2013, ku një marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua mes Bashkisë Elbasan dhe Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor, duke ndërmarrë kështu një hap tjetër në nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

### **Faqja Zyrtare e Bashkisë Elbasan**

Faqja zyrtare e Bashkisë Elbasan vlerësohet si një nga më aktivet e më të përditësuara për të gjitha informacionet, shërbimet apo aktivitetet e njësisë vendore.

Krahas informacioneve klasike mbi administratën e Bashkisë, përbërjen e Këshillit Bashkiak, njoftimin e mbledhjeve të KBE, apo shkarkimin e formularëve të ndryshëm, ajo ofron një sërë shërbimesh në mënyrë interaktive për qytetarët.

Kështu qytetarët mund t'i drejtojnë kërkesat apo ankesat e tyre drejtëpërdrejtë online nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan<sup>16</sup>. Proçesi kalon në tri etapa:

1. **Regjistrimi** i një kërkesë apo ankese nga qytetari;
2. **Ndjekja e statusit të kërkesës/ankesës:** Qytetari

mund të ndjekë zgjidhjen e problemit të tij online;

3. **Dokumenta të publikuara:** Qytetari mund të lexojë listën e dokumentave të bëra publike nga Bashkia.

Gjithashtu, nëpërmjet opsionit e-government realizohen sondazhe për vlerësimin e opinionit të qytetarëve për çështje të ndryshme që lidhen me shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Elemente mjaft interesant dhe të veçantë janë linku “e-pjesëmarrje” dhe “e-konsultime”, të cilët për herë të parë, po pilotohen në Bashkinë e Elbasanit. Pjesëmarrja elektronike<sup>17</sup> e qytetarit është një proces konsultimi on line, që përdor internetin për marrjen e opinionit publik në një çështje të caktuar, si dhe lejon diskutimin mes pjesëmarrësve në e-konsultim. Në këtë faqe është publikuar dhe një kalendar i cili paraqet çështjet për konsultim dhe periudhën kohore kur do të realizohet ky i fundit.

Këto risi teknologjike janë aplikuar dhe për prezantimin e projekt-buxhetit e paketës fiskale për vitin 2014, e cila është vënë në dispozicion të publikut gjatë tre-mujorit të fundit të vitit për t'u njohur me të dhe për të ofruar sugjerimet e tyre.

---

Këshillave të tjerë të monitoruar, përveç Lezhës, kjo e drejtë thjesht afirmohet, por nuk parashikohet në mënyrë specifike si do të realizohet ajo konkretisht.

<sup>15</sup> Publikohet numri, data dhe titulli i vendimit, por jo përmbajtja.

<sup>16</sup> Bashkia Elbasan dhe Bashkia Kamëz janë të vetmet njësi vendore që e ofrojnë këtë shërbim.

---

<sup>17</sup> Për më tepër shih: [www.epjesemarrje.gov.al/elbasani](http://www.epjesemarrje.gov.al/elbasani)

## **Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak Elbasan**

Duke patur parasysh kërkesat që përcakton ligji për qeverisjen vendore, Kryetari i Bashkisë dhe pjestarë të administratës kanë qenë prezent në të gjitha mbledhjet e këshillit duke raportuar për gjendjen ekonomiko-financiare, apo edhe për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e Bashkisë, sa herë që kjo e fundit është kërkuar nga këshilli.

## **Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje**

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje në Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak Elbasan vlerësohet në një shkallë mjaft të lartë. Kjo njësi vendore ka krijuar të gjitha kushtet për qytetarët që t'a ushtrojnë këtë të drejtë, jo vetëm nëpërmjet praktikës së përhapur të buxhetimit me pjesëmarrje, por edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve të reja teknologjike që lejojnë pjesëmarrjen e tyre qysh në fazat e hartimit të politikave qeverisëse lokale.

Komisioni i Këshillimit Qytetar Vendor (KKQV), i cili është institucionalizuar nëpërmjet nënshkrimit dhe të një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Elbasan, ka si synim ngritjen

e trajtimit të sa më shumë tematikave apo problemeve që shqetësojnë komunitetin në qytet, pranë kësaj njësie vendore. Ky organizëm vullnetar qytetar është pjesë e të gjitha proceseve konsultuese që lidhen me zhvillimet në bashki dhe që kanë impakt tek qytetarët.

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (e-government, e-participation, e-consultation) për të lehtësuar dhe ndihmuar pjesëmarrjen e qytetarëve e komunitetit në qeverisje lejojnë një qasje më strategjike dhe të konsiderueshme në përcaktimin e roleve përkatëse të qytetarëve, komuniteteve, këshilltarëve dhe zyrtarëve publikë në qeverisje. Kjo metodë sjell rezultate të shpejta dhe direkte në përmirësimin e qeverisjes, duke rritur bashkëveprimin me qytetarin, duke shtuar besimin dhe duke ofruar më shumë transparencë për komunitetin. Përdorimi i e-qeverisjes do të ndihmojë për të transformuar shërbimet publike duke rritur aksesin në informacion për qytetarin, duke rritur efektivitetin e shërbimeve, si dhe do të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve mes qytetarëve dhe administratës vendore.

## **BASHKIA KUKES**

### **Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Kukës**

Gjatë kësaj periudhe 6-mujore të monitorimit, Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Kukës (KBK) kanë qenë të hapura për të gjithë qytetarët të cilët janë interesuar për t'ë ndjekur zhvillimin e tyre.

Mbledhjet janë ndjekur nga përfaqësues të medias dhe diskutimet apo vendimet për çështje të rëndësishme së veçantë janë transmetuar/publikuar edhe në televizionet apo gazetatat lokale.

Njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve dhe përmbajtjen e rendit të ditës janë publikuar në mënyrë të kënaqshme në stendën e vendosur në mjediset e jashtme të Bashkisë, si edhe në median lokale. Gjatë 2 muajve të fundit, njoftimi i zhvillimit të mbledhjeve është bërë edhe nëpërmjet faqes zyrtare në facebook të Bashkisë Kukës.

Zhvillimi i mbledhjeve ka qenë i rregullt e me një pjesëmarrje të plotë nga ana e të gjithë këshilltarëve, pavarësisht se jo të gjithë janë përfshirë në diskutimin e çështjeve të ditës me të njëjtin intensitet.

Materiali për mbledhjen e radhës iu është dërguar në kohë të gjithë këshilltarëve, duke lejuar konsultimin e tyre nga komisionet përkatëse. Të gjitha vendimet që janë marrë kanë qenë transparente, pasi votimi është bërë kurdoherë në mënyrë të hapur dhe ka ndodhur pas shterimit të të gjitha diskutimeve.

Megjithë përpjekjet e administratës për t'i garantuar qytetarëve pjesëmarrjen në mbledhjet e KBK, me përjashtim të ndonjë individi drejtëpërdrejtë të interesuar, mbledhjet nuk janë ndjekur në mënyrë të rregullt nga qytetarët. Kjo ka ardhur si pasojë e interesit të ulët të qytetarëve për të qenë pjesë e seancave, por paraprakisht edhe hapësira e sallës së mbledhjeve të KBK nuk i plotëson kushtet për numër më të madh të qytetarëve.

Në dhjetor Bashkia Kukës ka krijuar një faqe të re zyrtare, ku ndër të tjera ka një seksion për Këshillin Bashkiak. Në këtë seksion, krahas informacioneve mbi aktivitetet e Bashkisë apo përbërjes së Këshillit Bashkiak, qytetarët kanë akses dhe në titujt e vendimeve të marra gjatë 2012 dhe 2013.

Vendimet e plota publikohen në stendën jashtë godinës së Bashkisë, por janë evidentuar probleme me përditësimin e rregullt të tyre.



## Faqja Zyrtare e Bashkisë Kukës

Faqja e internetit e Bashkisë Kukës përmban një sërë informacionesh për qytetarët, lidhur me administratën e Bashkisë, përbërjen e KBK, shërbime të ndryshme apo projektet e zbatuara në qytet.

Gjithashtu, edhe aktivitetet e Bashkisë pasqyrohen në mënyrë të përditësuar. Nëpërmjet saj qytetarët mund të njihen dhe me një dokument strategjik mjaft të rëndësishëm për qytetin, siç është Plani i Veprimit për Bashkinë Kukës<sup>18</sup> për vitet 2011-2015. Duke qënë në hapat e parë të ndërtimit të kësaj faqeje të re, ka ende vend për përmirësim dhe pasurim të saj nga ana e administratës, në mënyrë që t'a lehtësojnë më tepër marrjen e informacionit nga qytetarët dhe grupet e interesit.



## Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak Kukës

Kryetari i Bashkisë dhe drejtorët e drejtorive të ndryshme kanë dhënë sqarime dhe kanë raportuar në çdo mbledhje të KBK. Kryetari KBK dhe Kryetari i Bashkisë pas përfundimit të

mbledhjeve kanë marr iniciativën për tu takuar me qytetarë për t'i informuar rreth zhvillimeve që ndodhin në këshill për çështje të caktuara, kjo tregon se llogaridhënia nga ana e anëtarëve ka qënë shumë e kënaqshme

## Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje

Në rregulloren e Këshillit Bashkiak Kukës nuk parashikohet shprehimisht detyrimi për këshillim, por ajo referon që për rastet që nuk parashikohen në rregullore të zbatohet ligji për qeverisjen vendore ose të vendoset me vendim këshilli se si do të veprohet.

Në praktikë ky detyrim i organeve të njëjësive të qeverisjes vendore realizohet me anë të:

- procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, si një ndër fazat e para të hartimit të projekt-buxhetit dhe paketës fiskale për vitin pasardhës;
- të dëgjimit në mbledhjet e këshillit të opinionëve të ekspertëve apo qytetarëve të thjeshtë për çështjet që prekin interesat e tyre.

Në takimin e realizuar në këtë qytet, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kukës theksuan nevojën për organizimin nga ana KBK të konsultimeve më të shpeshta me qytetarët dhe shoqatat.

<sup>18</sup><http://www.kukesi.gov.al/bashkia/permbajtia/uploads/2013/11/Plani-i-Zhvillimit-Kukes.pdf>



## **BASHKIA LEZHE**

### **Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Lezhë (KBL)**

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Lezhë janë realizuar në mënyrë të rregullt dhe madje në mënyrë edhe më të shpeshtë se kriteri i përmuajshëm që parashikohet në ligjin për qeverisjen vendore.

Njoftimet për mbledhjet dhe takimet e komisioneve të Këshillit, së bashku me përshkrimin e rendit të ditës janë bërë publike në afatin e caktuar ligjor, si dhe janë publikuar në ueb-faqen e Bashkisë, në stendën para saj, apo edhe në faqen e Bashkisë në Facebook.

Mbledhjet janë shoqëruar me shprehjen e opinioneve nga pothuajse të gjithë anëtarët e Këshillit, të cilët janë treguar mjaft të përfshirë në diktatimet për çështjet e ditës. Shpesh ka patur kritika për pjesëmarrjen e anëtarëve në komisionet përkatëse dhe është kërkuar shtyrja e mbledhjes për një datë mjaft të afërt, në mënyrë që t'i jepej mundësia të gjithë këshilltarëve të njiheshin me relacionet shpjeguese të akteve të sjella para tij.



Publikimi i vendimeve (jo përmbajtja, por vetëm titulli dhe nr.) është bërë edhe në faqen zyrtare të Bashkisë, por është e nevojshme përditësimi më i mirë i tyre<sup>19</sup>.

Salla e mbledhjeve të Këshillit ka vende të rezervuara për mediat, organizatat e Shoqërisë Civile dhe për qytetarë. Gjatë periudhës së monitorimit, të gjitha mbledhjet e KBL kanë qenë të hapura për publikun dhe mediat kanë qenë të pranishme. Mediat shprehen që ndihen të lira gjatë realizimit të punës së tyre. Informacionet zakonisht merren dhe nga takimet me drejtorët, ndërsa nga Zyra për Informim merren njoftimet për takime apo aktivitetet e ndryshme.

### **Faqja Zyrtare e Bashkisë Lezhë**

Faqja zyrtare e Bashkisë Lezhë vlerësohet si mjaft e mirë për informimin dhe shërbimin ndaj qytetarëve, meqenëse ka informacion të zgjeruar dhe kryesisht të përditësuar. Në ueb-faqe publikohen të gjitha aktivitetet e Bashkisë, si edhe njoftimet për mbledhjet e KBL apo dhe njoftimet për vende të lira pune në administratën e Bashkisë. Pjesë e saj janë dhe investimet apo projektet në zbatim dhe ato të përfunduara të Bashkisë. Nuk mungojnë në këtë faqe edhe strategjitë e Bashkisë apo planet zhvillimore dhe informacionet kulturore mbi historinë dhe traditat e qytetit.

<sup>19</sup> Në ueb-faqen e Bashkisë Lezhë figurojnë të fundit vendimet e periudhës Janar-Maj 2013.

## **Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak Lezhë**

Drejtnesit më të lartë të administratës së Bashkisë Lezhë kanë qenë prezent në të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Në varësi të çështjeve të trajtuara, administrata ka bërë të mundur dhe pjesëmarrjen e ekspertëve të ndryshëm për të dhënë sqarime para Këshillit për projektet e paraqitura nga Bashkia për miratim.

Kryetari i Bashkisë ka qënë i hapur me qytetarët dhe ka marrë pjesë personalisht në takimet e zhvilluara për hartimin e paketës fiskale për vitin 2014-2016 të Bashkisë Lezhë.

## **Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje**

Krahas krijimit të infrastrukturës së nevojshme për pjesëmarrjen e qytetarëve në mjedisin e zhvillimit të mbledhjeve të KBL, Bashkia e Lezhës ka organizuar në nëntor të 2013 një dëgjese publike<sup>20</sup> për paketën fiskale 2014-2016.

Një arritje pozitive në këtë aspekt është prezantimi paraprak i materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë në ueb-faqen zyrtare si edhe në faqen në Facebook, në mënyrë që qytetarët dhe grupet e interesit të njiheshin paraprakisht me të, për të përgatitur kështu dhe sugjerimet që mund t'i drejtonin administratës në ditën e takimit.

Buxhetimi me pjesëmarrje konsiderohet se i përfshin qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve

për shpenzime dhe prioritete të buxhetit publik.

Gjithashtu në Rregulloren e KBL janë të parashikuara format me anë të të cilave mundësohet përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje<sup>21</sup>.

---

20

<http://www.lezha.org/mat.php?lang=1&idm=1382&idr=33>

---

<sup>21</sup> Neni 19 i Rregullores së funksionimit të KBL

## **BASHKIA POGRADEC**

### **Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Pogradec (KBP)**

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak Pogradec nuk janë mbajtur në përputhje me ligjin për qeverisjen vendore, pasi në muajt tetor dhe nëntor nuk janë zhvilluar mbledhje.

Sa i përket procedurave të shpalljes së njoftimeve për kohën dhe rendin e mbledhjeve, ato kanë vazhduar të bëhen konform ligjit dhe janë bërë publike në një stendë para godinës së Bashkisë (këndi i transparencës). Mbledhjet e zhvilluara gjatë këtij 6-mujori janë mbajtur me transparencë të plotë sa i përket procesit të hapur të votimit dhe pjesëmarrjes së publikut. Natyrisht që pjesëmarrja qytetare nuk ka qenë shumë e kënaqshme, kjo ndoshta edhe si pasojë e mosgatishmërisë së tyre për pjesëmarrje në aktivitete të tilla. Ekipi ynë monitorues nuk ka hasur në ndonjë pengesë për të poseduar ndonjë dokument të kërkuar.



Mediat lokale kanë qenë të pranishme pothuajse gjatë gjithë mbledhjeve të KBP. Ato zakonisht janë korrespondentë lokal të gazetave ditore dhe nga televizionet lokale. Qasja e tyre është e pa penguar në vëzhgimin e seancave, duke pasur një trajtim të barabartë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucione tjera të interesuara.

Bashkia Pogradec ka një faqe zyrtare ku publikohet informacion mbi qytetin, por sugjerimi është që pjesë e saj të bëhen dhe informacione mbi mbledhjet e KBP, vendimet e marra prej tij, si edhe projektet e bashkisë për qytetin, duke krijuar kushtet e një komunikimi sa më të gjerë dhe transparent me qytetarët.

### **Faqja Zyrtare e Bashkisë Pogradec**

Bashkia Pogradec ka një faqe zyrtare<sup>22</sup> që përmban kryesisht informacion me karakter turistik për qytetin dhe për aktivitete të këtij lloji të organizuara nga Bashkia. Vlerësojmë se është i nevojshëm publikimi në këtë faqe i informacioneve mbi administratën e bashkisë, shërbimeve që ofrohen për qytetarët, si edhe informacion mbi KBP. Duhet bërë më tepër përpjekje për garantimin e të drejtës së informimit pasiv të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.

<sup>22</sup> <http://bashkiapogradec.gov.al/>

## Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak Pogradec

Marrdhënia e ekzekutivit me KBP ka qënë mjaft e mirë dhe konstruktive. Pavarësisht diskutimeve të ndryshme, sidomos në mbledhjen e diskutimit të projekt-buxhetit dhe paketës fiskale, në sajë të raportimit dhe sqarimit nga ana e administratës së Bashkisë për çështjet e debatuar, është arritur miratimi i këtij akti, duke i hapur rrugë kështu investimeve për qytetin.

## Llogaridhënia në Këshillin Bashkiak Pogradec

Kryetari i Bashkisë dhe pjestarë të administratës kanë qënë prezent në të gjitha mbledhjet e këshillit duke raportuar për probleme që kanë të bëjnë me funksionet e Bashkisë apo sa herë që janë kërkuar sqarime para miratimit të akteve të ndryshme nga Këshilli.

## Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje

Në Bashkinë Pogradec, kjo e drejtë garantohet edhe në sajë të parashikimit në rregulloren e Këshillit Bashkiak të detyrimit për këshillim, edhe pse kryesisht bëhet referim tek rastet e këshillimit të detyrueshëm që parashikon ligji për qeverisjen vendore.

Një nismë interesante në këtë drejtim, ka qënë ajo e monitorimit të mbledhjeve nga një grup nxënësish të shkollave të mesme, si një formë e nxitjes së të rinjve për të qënë më të përfshirë në vendimmarrjen për qytetin.

Në praktikë përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje është realizuar nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, vetëm në sajë të zhvillimit të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, që konsiston në zhvillimin e takimeve me komunitetin para miratimit të paketës fiskale e projekt-buxhetit. Megjithatë, nga deklaratimet e përfaqësuesve të shoqatave dhe nga ngjarjet e fundit të protestave të qytetarëve, rezulton se ky proces nuk ka qënë i kënaqshëm.

## REKOMANDIME

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, krahas gjetjeve dhe eksperiencave pozitive që kemi patur në secilën prej Bashkive dhe Këshillave Bashkiakë të përfshirë në projekt, TIA sugjeron rekomandimet e mëposhtme për nxitjen e mëtejshme të transparencës në qeverisjen vendore.

- Anëtarët e Këshillit Bashkiak të jenë më aktiv në mbledhje duke trajtuar çështjet në diskutim;
- Duke respektuar procedurat ligjore, këshilltarët të sjellin propozime konkrete për temën në diskutim apo të sjellin propozime të reja, duke mos qënë çdo herë pro propozimeve të sjella nga administrata e Bashkisë;
- Këshilltarët të jenë më të kujdesshëm gjatë zhvillimit të seancave duke lënë mënjane punët dhe obligimet tjera dhe të jenë 100% pjesë e zhvillimeve, që do të thotë më pak telefonata dhe lëvizje gjatë zhvillimit të mbledhjeve;
- Këshilltarët duhet të jenë vazhdimisht të lidhur dhe në konsultim me qytetarët, po ashtu tu përgjigjen ftesave të organizatave të Shoqërisë Civile për t'u njohur më mirë me problemet e grupeve të ndryshme të komunitetit;
- Në secilën Bashki të institucionalizohet ekzistenca e Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor, të përbërë nga përfaqësues të komunitetit dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme, që do të ndihmonte Këshillin por edhe Ekzekutivin në nxjerrjen e akteve vendore sa më lehtë të aplikueshme dhe në të mirë të komunitetit;
- Të dhëna mbi investimet kapitale, kontratat e prokurimeve dhe raportet e shpenzimit të parasë publike për periudha të ndryshme mujore apo ato vjetore financiare, të publikohen në faqet zyrtare të Bashkive;
- Sektori financiar duhet të përmirësojë përfomancën në vjeljen e taksave dhe tarifave vendore;
- Konsultimet me publikun të jenë më të shpeshta dhe jo vetëm për çështjet e detyrueshme nga ligji për qeverisjen vendore (megjithëse konsultimi është ligjërish i detyrueshëm dhe në rastin e tjetërsimit të pronave për të tretët, kjo nuk është realizuar pothuasje në asnjë rast);
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në këshill dhe në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronave vendore, planifikimin urban, investimet, të ardhurat dhe çështje tjera me interes publik;
- Zyra për Informim të angazhohet më tepër për përditësimin e ueb-faqes zyrtare të Bashkisë me informacione të rëndësishme për qytetarët;
- Publikimi i plotë në përmbajtje i vendimeve të Këshillit Bashkiak të bëhet dhe në faqet zyrtare të Bashkive dhe të jetë i përditësuar.

## PËRMBYLLJE

Transparenca e institucioneve publike vendore është baza për të rritur përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve ndaj qytetarëve. Meqënëse janë qytetarët, ata që kontribuojnë me paratë e tyre në funksionimin e këtyre organizmave, atëherë vetë interesi publik për t'u informuar rreth mënyrës së shpenzimit të tyre është mjaft i madh.

Aksesi në të dhënat zyrtare bën të mundur evidentimin e mangësive të mundshme të efikasitetit në qeverisje, duke krijuar mundësi vlerësimi dhe përmirësimi për një menaxhim sa më të mirë të shërbimeve apo asetëve publike.

Një sistem qeverisës transparent duhet të parashikojnë procedura të qarta për vendimmarrjen publike dhe të garantojë kanale të hapura të komunikimit ndërmjet palëve të interesuara e zyrtarëve, si dhe mundësojnë një seri të gjerë informacioni. Aksesi i lirë ndaj informacionit luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës.

Angazhimi qytetar nënkuptohet si një pjesëmarrje aktive në jetën e qytetarëve

dhe në kontributin e tyre. Niveli i besimit në pushtetin lokal përbën një faktor kryesor që përcakton masën dhe cilësinë e angazhimit qytetar. Besimi në organet publike ndikohet nga dy faktorë: nga cilësia e shërbimit që marrin individët dhe familjet e tyre, dhe nga fakti se sa transparente e të ndershme janë autoritetet në lidhje me performancën e tyre, duke përfshirë gadishmërinë e tyre për të pranuar dhe për të mësuar rreth gabimeve të tyre.

Transparenca nuk ndihmon vetëm në informimin e publikut në lidhje me zhvillimin e ideve dhe propozimeve, por edhe për të bindur qytetarët se agjensitë publike janë të interesuara në dëgjimin e pikëpamjeve të tyre dhe përgjigjen e prioriteteve të qytetarëve. Kjo nga ana tjetër rrit legjitimitetin e procesit të vendimmarrjes dhe forcon "demokracinë e drejtpërdrejtë".

Transparenca gjithashtu ndikon në angazhimin qytetar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Qeveritë lokale duhet të ndajnë vlerësimet dhe planet e tyre me qytetarët si edhe të kërkojnë pikëpamjet e tyre mbi baza të rregulta të cilat mund të jenë shumë efektive në zbatimin e programeve të zhvillimit të komunitetit.

**Transparency International Albania**

Bul. "Gjergj Fishta", Kulla 5, Kati 2, Ap.6, Tiranë

Tel: +355 42 267 457

E-mail: [leginet@albaniaonline.net](mailto:leginet@albaniaonline.net) ;

Web:

[www.tia.al](http://www.tia.al)

<http://www.transparencavendore.tia.al/>